

VENDIM
Nr. 578, datë 3.8.2016

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKONSTRUKSION I RRUGËS “DERVISH HEKALI”, I HAPËSIRAVE PËRRETH SAJ DHE REHABILITIMI I FASADAVE”, FIER

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i rrugës “Dervish Hekali”, i hapësirave përreth saj dhe rehabilitimi i fasadave”, Fier.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Fier.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë sipërfaqe “tokë truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 28 382 143 (njëzet e tetë milionë e treqind e tetëdhjetë e dy mijë e njëqind e dyzet e tre) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 28 382 143 (njëzet e tetë milionë e treqind e tetëdhjetë e dy mijë e njëqind e dyzet e tre) lekësh, të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

5. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në “Fletoren zyrtare”.

6. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Fier.

7. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Fier, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

9. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier dhe Bashkia Fier për zbatimin e këtij vendimi.

10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E TË CILËVE DO TË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT "RIKONSTRUKSION I RRUGËS "DERVISH HEKALT", I HAPËSIRAVE PËRRETH SAJ DHE REHABILITIMI I FASADAVE", FIER

Nr.	Emër, mbiemër	Zona Kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e përgj. e truallit (m ²)	Sip. e prekur e truallit (m ²)	Çmimi për truallin (lekë/m ²)	Vlera e truallit (lekë)	Sip. totale e ndërtesës me certifikatë (m ²)	Sip. e prekur e ndërtesës (m ²)	Amortizimi (%)	Vlera e ndërtesës me preventiv (lekë)	Vlera e përgjith. (lekë)	Gjendja juridike e pasurisë
1	Kristaq Llazi Daka	8533	5/351	-	-	-	0	60	43	20%	1,456,079	1,456,079	Konfirmim nga ZVPP-ja
2	Kristaq Llazi Daka	8533	5/648	60.0	60.0	11,026	661,560	-	-	-	-	661,560	Konfirmim nga ZVPP-ja
3	Pajtim Baho dhe Kujtim Rexhepi	8533	5/479	78.0	78.0	11,026	860,028	345.6	345.6	5%	12,859,474	13,719,502	Konfirmim nga ZVPP-ja
4	Vergjeni Papuciu	8533	5/353	80.0	80.0	11,026	882,080	80.0	80.0	5%	2,957,879	3,839,959	Konfirmim nga ZVPP-ja
5	Armando Aziz Rexhepi dhe Besnik Aziz Rexhepi	8533	5/217 - N3	-	-	11,026	0	34.0	34.0	5%	1,280,896	1,280,896	Konfirmim nga ZVPP-ja
6	Arben Xhevit Borici	8533	5/217 +1-2	-	-	11,026	0	97.5	97.5	5%	4,068,051	4,068,051	Konfirmim nga ZVPP-ja
7	Ilir Loni Nushi	8533	5/217 - N2			11,026	0	37.0	37.0	5%	1,570,764	1,570,764	Konfirmim nga ZVPP-ja
8	Bahare Gjysho Begaj	8532	5/158	40.0	40.0	12,458	498,320	-	-	-	-	498,320	Konfirmim nga ZVPP-ja
9	Florika Naun Xhaho	8532	5/150	28.8	28.8	12,458	358,790	28.8	28.8	10%	928,222	1,287,012	Konfirmim nga ZVPP-ja
Vlera totale											28,382,143		

Vlerësimi është bërë duke zbatuar VKM-në nr. 138, datë 23.3.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë për interes publik" dhe VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".